

# HIDROKOL S

*Ngjitës një-komponentësh për pllaka, i pa depërtueshëm ndaj ujit, i prodhuar në bazë çimentoje. Përgjigjet në EN 12004, klasi C2 E*

## Fusha e aplikimit:

Për ngjitje të pllakave qeramike për dysheme dhe mure, për përdorim të jashtëm, si dhe për pozita të cilat janë të ekspozuara në lagështi dhe ujë: nyje sanitare, banjo, pishina, tarraca, shatërvanë dhe ngjashëm. Te sipërfaqet që nuk janë të rrafshëta, gjatë ngjitjes së pllakave me Hidrokol S vendet që nuk janë të rrafshëta mund të korrigjohen, në shtresë me trashësi deri 1 cm.

## Cilësi:

- ngjitshmëri e mirë
- adezion i shkëlqyer I
- padepërtueshëm ndaj ujit
- përgatitje e thjeshtë
- aplikim I thjeshtë
- kohë e zgjatur e hapur për punë
- ekonomik

## Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Pluhur i përhimët
Klasi	EN 12004	C2E
W/M faktor ujë/material	-	0,2-0,28
Kohë e hapur për ngjitje në temperaturë prej 20° C	EN 1346	30 minuta
Punueshmëri në temperaturë prej 20° C	-	3 orë
Adezion për nënshtresën gjatë kushteve normale	EN 1348	>1,0MPa
Adezion për nënshtresën pas zhytjes në ujë	EN 1348	>1,0MPa
Adezion për nënshtresën pas ciklit të ngrirjes/shkrirjes	EN 1348	>1,0MPa
Fillimi i lidhjes	-	3-6 orë
Fundi i lidhjes	-	10-12 orë

## Metodologjia e vendosjes:

### Përgatitje e nënshtresës:

Hidrokol S vëhet në nënshtresë të shëndoshë të betonit, suva çimentoje ose të zgjatur. Nënshtresa duhet të jetë e pastër, pa pluhur dhe e lagur mirë me ujë.

### Vendosje:

Hidrokol S përgatitet me shtimin e ujit, me ç'rast masa përzihet vazhdimisht deri në homogjenizimin e plotë. Pas përzierjes, duhet të lihet të rri më së shumti 10 - 15 minuta pas së cilës përzihet sërish dhe aplikohet.

Vendosja është me glet-vegël të dhëmbëzuar ose me shpahëll në shtresë prej 4 – 10 mm, në tërë sipërfaqen e nënshtresës ku duhet të ngjiten pllakat në ngjitësin e vendosur. Para instalimit pllakat duhet të vendosen në ujë dhe me shtypje duhet të ngjiten në ngjitësin e vendosur. Kohë e hapur për vënie të materialit të përzier është 30 minuta, në temperaturë prej 20° C. Temperatura e nënshtresës gjatë vendosjes duhet të jetë midis 5o C deri 35o C. Shtresat midis pllakave duhet të përpuhohet me përzierje për fugim Fugofill, më herët 24 orë pas vendosjes.

## Shpenzimi:

për shtresë me trashësi prej 1 mm ~ 1,1 kg/m<sup>2</sup>  
varësisht nga nënshtresa ~ 3,3-6,6 kg/m<sup>2</sup>

## Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohen me ujë pas përdorimit.

## Paketimi:

Ventil thasë 25kg

## Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të thata në temperaturë prej 5o C deri +35o C. Afati i përdorimit përdorimit 12 muaj.

**Rrezik për jetën:** Nevojitet që të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën, si dhe thithje e drejtpërdrejtë të pluhurit. Gjatë kontaktit me prodhimin, menjëherë duhet të mënjanohet me sapun dhe ujë. Nëse materiali rastësisht vjen në kontakt me sytë, menjëherë duhet të shpëlahet me ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gëlltitet, nevojitet së menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore.

**Zjarr:** Prodhimi nuk mund të ndizet.

**Pastrimi dhe depozitimi:** Pastrimi është me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullatave lokale për atë lloj të mbetjeve. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.